



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



DEPARTAMENTI I GAZETARISË

MONITORIMI I PARAQITJES SË GRAVE NË DEBATET TELEVIZIVE GJATË FUSHATËS PËR ZGJEDHJET LOKALE 2021

Prishtinë, 2021

Ky hulumtim është realizuar në kuadër të bashkëpunimit të Komisionit të Pavarur të Mediave me Universitetin e Prishtinës - Departamentin e Gazetarisë, dhe Institutin e Mediave të Kosovës.

Përmbajtja

Hyrje	4
Metodologjia	5
Rezultatet e monitorimit të pjesëmarrjes së grave në debatet elektorale për zgjedhjet lokale të mbajtura në nëntor 2021	6
Përfundimet.....	17

Tabela e figurave

Tabela 1 Pëfaqësimi i gruas në televizione.....	6
Tabela 2 Pëfaqësimi i gruas në emisionet zgjedhore	7
Tabela 3 Përkatësia politike e grave dhe përfaqësimi në emisione	7
Tabela 4 Koha që kanë kaluar gratë duke folur/diskutuar në emisione	8
Tabela 5 Sa herë i është ndërprerë fjala grave ne emision.....	9
Tabela 6 Sa herë kanë ndërhyrë kandidatet gra gjatë emisioneve.....	9
Tabela 7 Sa herë e kanë refuzuar ftesën për emisione gratë	10
Tabela 8 Tema e pandemisë/shëndetësisë e trajtuar nga gratë në emisione.....	11
Tabela 9 Tema e punësimit e trajtuar nga gratë në emisione	11
Tabela 10 Tema e papunësisë e trajtuar nga gratë në emisione	12
Tabela 11 Tema e drejtësisë e trajtuar nga gratë në emisione.....	12
Tabela 12 Tema e korrupsionit e trajtuar nga gratë në emisione	13
Tabela 13 Tema e mbështetjes sociale e trajtuar nga gratë në emisione.....	13
Tabela 14 Tema e bujqësisë e trajtuar nga gratë në emisione	14
Tabela 15 Tema e kulturës e trajtuar nga gratë në emisione	14
Tabela 16 Tema e sportit e trajtuar nga gratë në emisione	15
Tabela 17 Të drejtat e grave të trajtuara nga gratë në emision	16
Tabela 18 Tema e arsimit e trajtuar nga gratë në emisione.....	16

Hyrje

Departamenti i Gazetarisë i Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM) dhe Institutin e Mediave të Kosovës (IMK), kanë realizuar këtë projekt hulumtues me titull: “Monitorimi i paraqitjes së grave në debatet televizive gjatë fushatës mbi zgjedhjet lokale 2021”.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi ka qenë monitorimi i debateve televizive dhe prezantimi i grave në këto debate, në televizione të ndryshme të cilat operojnë në Kosovë.

Në këtë hulumtim janë monitoruar 327 emisione, ndërkaq, për herë të parë në këto zgjedhje pozitën e krytarit e kanë synuar njëmbëdhjetë gra nga komunat e Kosovës. Gjatë gjithë fushatës elektorale mediet në Kosovë i kanë përcjellë ngjarjet dhe aktivitetet politike, por, edhe kanë organizuar debate të veçanta kushtuar këtyre zgjedhjeve.

Përmes këtij hulumtimi është analizuar pjesëmarrja e grave në debate politike, hapësira që i është dhënë atyre, temat që janë diskutuar, numri i grave prezente si dhe çështje të tjera që ndërlidhën me procesin e zgjedhjeve lokale. Analizimi i këtyre debateve publike të shfaqura në televizione është bërë nga data 16.09.2021 dhe deri më 15.10.2021, periudhë e fushatës zgjedhore e paraparë me Ligjin për Zgjedhjet.

Objekt i analizës kanë qenë emisionet e tetë medieve të ndryshme si: Televizioni Publik i Kosovës (RTK1), Kohavision (KTV), Radio Televizioni 21 (RTV21), Klan Kosova, Televizioni 7, Kanal 10, Radio Televizioni Dukagjini dhe televizioni ATV.

Ky projekt është mbikqyrur nga Departamenti i Gazetarisë, ndërsa në implementimin e tij ka dhënë një kontribut të rëndësishëm Komisioni i Pavarur i Mediave pasi që i gjithë procesi i monitorimit të mediave është kryer në zyrën e KPM-së, nën asistencën e Departamentit të Monitorimit dhe Analizës si dhe është mbështetur gjithashtu nga Instituti i Medias së Kosovës.

Ky hulumtim është realizuar pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit në mes të Departamentit të Gazetarisë dhe Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM). Në hulumtimishin të përfshirë katër studentë të Departamentit të Gazetarisë, Altiana Zogaj, Rreze Sylhasi, Shefket Bujari dhe Shpresë Hasimi.

Metodologjia

Gjatë këtij hulumtimi është përdorur metodologjia e njëjtë për të gjitha emisionet që kanë qenë të transmetuara në tetë televizione të ndryshme. Në kuadër të këtij hulumtimi është përdorur mostër e qëllimtë, e cila është ndërlidhur me një muaj të fushatës elektorale për zgjedhjet lokale 2021. Në hulumtim është përdorur metoda kuantitative dhe janë analizuar përgjigjet e trembëdhjetë pyetjeve të koduara, të cilat lidhen drejtpërdrejt me gjetje konkrete brenda këtij hulumtimi. Tetë televizionet e përfshira në këtë hulumtim janë: Radio Televizioni i Kosovës (RTK1), Radio Televizioni 21 (RTV21), Kohavizion (KTV), Radio Televizioni Dukagjini, Klan Kosova, Kanal 10 dhe ATV. Emisionet e zgjedhura në këto televizione, kanë qenë emisionet e transmetuara në “prime time”, duke filluar nga ora 19:00 deri në orën 22:00.

Periudha kohore e analizimit të këtyre emisioneve ka qenë data 16.09.2021, ku edhe shënohej fillimi i fushatës zgjedhore e deri në datën 15.10.2021, një ditë para heshtjes zgjedhore në vend.

Që analizimi i rezultateve të jetë sa më i saktë është përdorur programi statistikor (SPSS), në të cilin janë caktuar pyetjet e ndryshme që lidhen me temën bashkë me variablat dhe me vlerat e dhëna për to.

Pyetjet në të cilat iu është përgjigjur në këtë hulumtim janë bazuar në përkatësinë politike të pjesëmarrëseve gra, numrin e të ftuarve në analogji me numrin e grave mysafire në studio, funksionin që e ushtrojnë gratë e ftuara në emisione, kohëzgjatjen e fjalës, ndërprerjet brenda emisionit dhe ndërhyrjet që ajo apo ato kanë bërë. Duke mos harruar edhe temat të cilat janë përmendur gjatë emisionit.

Rezultatet e monitorimit të pjesëmarrjes së grave në debatet elektorale për zgjedhjet lokale të mbajtura në nëntor 2021

Për tridhjetë ditë të fushatës elektorale të zgjedhjeve lokale në Kosovë, janë monitoruar emisionet zgjedhore të tetë televizioneve në kontekstin e përfatjes gjinore dhe hapësirës që është dhënë pjesëmarrseve gra në këto emisione. Për gjatë kësaj periudhe janë analizuar dhe monitoruar rreth 327 emisione elektorale me ç'rast në vazhdim do të prezentohen edhe rezultatet e këtij monitorimi.




Tabela 1 Përfatja e gruas në televizione

Në bazë të rezultateve të dalura në pikën e parë të monitorimit rreth pjesëmarrjes së grave në debatet zgjedhore, rezultatet kanë treguar një përfatje të ndryshme të grave në emisione. Në Radio Televizionin e Kosovës (RTK1), në emisionet e monitoruara është vërejtur një disproportione në përfatjen gjinore, ku nga 30 emisione vetëm në 9 prej tyre ka pasur të ftuara gra, ndërsaq në 21 emisione nuk ka qenë e ftuar asnjë grua. Në KTV nga 23 emisione të monitoruara vetëm në 8 ka pasur përfatje të grave, në Televizionin 21 nga 18 emisione vetëm në 6 ka pasur gra të ftuara në panel. Ndërsaq, televizioni me më së shumti përfatje të grave në këto debate ka qenë Televizioni Dukagjini, ku vetëm në 2 emisione nuk ka pasur të ftuara gra, ndërsaq numri i grave të ftuara në debate ka qenë i madh apo 160 gra të ftuara.




Tabela 2 Përfaqësimi i gruas në emisionet zgjedhore

Në tabelën e dytë janë paraqitur rezultatet e përfaqësimit të gruas në emisione të ndryshme zgjedhore.




Tabela 3 Përkatësia politike e grave dhe përfaqësimi në emisione

Në të gjitha debatet e monitoruara kanë marrë pjesë 221 gra të ftuara nga të gjitha subjektet politike garuese në zgjedhjet lokale, ku me pjesëmarrje të grave prinë PDK-ja me 54 pjesëmarrëse gra në emisione, LDK me 50 gra të ftuara, VV me 47 gra të ftuara, me 38 gra të ftuara AAK, 8 AKR, 7 NISMA, 2 Iniciativa Qytetare dhe të tjerat me nga një grua të përfaqësuar. Ndërsa, vetëm në emisionin “Debat përnime” të transmetuar në Televizionin Dukagjini kanë qenë të ftuara 160 gra, nga të gjitha subjektet politike. Gjithashtu, në kuadër të kësaj është monitoruar edhe minutazhi i cili i është lejuar për diskutim grave të përfaqësuar në emisione, ku në rreth 151 raste grave iu është lejuar të flasnin deri në 5 minuta, në 16 raste deri në 10 minuta, në 14 raste deri në 15 minuta, 11 raste deri në 20 minuta, 12 raste deri në 25 minuta, 2 raste deri në 30 minuta dhe 2 raste mbi 30 minuta. Në shumicën e rasteve kur kemi të bëjmë me kohën mbi 30 minutësh kemi të bëjmë me gra të cilat kanë qenë candidate për kryetare të komunave.

Në bazë të tabelës së radhës rezulton se në shumicën e rasteve grave të ftuara në emisione nuk i është dhënë hapësirë më e madhe se pesë minuta. Është përqindje e vogël e rasteve, kur gjatë diskutimeve në emisionet e monitoruara, mysafireve të ftuara gra i është dhënë fjala deri në dhjetë minuta, ndërkaq, mbi dhjetë minuta të ftuarat kanë diskutuar vetëm në rastet kur kanë qenë të ftuara si candidate për kryetare.




Tabela 4 Koha që kanë kaluar gratë duke folur/diskutuar në emisione

Gjithashtu në kuadër të këtij hulumtimi është bërë edhe monitorimi i ndërprejes së fjalës që i është bërë grave të ftuara në emision. Në bazë të kësaj variable rezulton se grave të ftuara në emisionin “Context”, fjala iu është ndërprerë më shumë se katër herë, ndërsa krejt e kundërta është në emision

“Debat përnime”, debat i kallxo.com i transmetuar në Televizionin Dukagjini ku nga 159 të ftuarave gra, fjala nuk iu është ndërprerë asnjëherë 146 të pranishmëve në emision.




Tabela 5 Sa herë i është ndërprerë fjala grave ne emision

Ndërsa sa i përket ndërhyrjeve të grave gjatë debateve televizive, sipas tabelës së mëposhtme rezulton se nga 210 prezantime të grave në emisione, ato nuk kishin ndërhyrë asnjëherë në 171 raste, ndërsa, kishin ndërhyrë në debate deri në 6 herë në rreth 39 raste.




Tabela 6 Sa herë kanë ndërhyrë kandidatet gra gjatë emisioneve

Gjatë monitorimit është bërë hulumtim edhe mbi rastet kur në debatet zgjedhore gratë i kanë refuzuar ftesat në emisione, dhe sipas matjeve rezultoi se në 12 raste në emisione të ndryshme gratë i kanë refuzuar ftesat për debate. Kjo është bërë e ditur nga ana e udhëheqësve të emisioneve elektorale në televizionet që kanë qenë në fokus të monitorimit.




Tabela 7 Sa herë e kanë refuzuar ftesën për emisione gratë

Gjatë monitorimit të medieve është bërë edhe analizimi i temave që janë diskutuar me gratë gjatë prezencës së tyre në emisione. Në vazhdim janë të prezantuara edhe disa nga fushat e ndryshme që janë diskutuar me gratë e ftuara në emisionet e destinuar për zgjedhjet lokale të mbajtura në tetor 2021.




Tabela 8 Tema e pandemisë/shëndetësisë e trajtuar nga gratë në emisione

Nga totali i 207 rasteve të diskutimit me prezencën e grave në emision në 92 raste janë diskutuar temat që ndërlidhen me pandeminë COVID-19 dhe temat e tjera që ndërlidhën me shëndetësinë, karshi 115 rasteve që nuk janë trajtuar fare temat që ndërlidhën me shëndetësinë.




Tabela 9 Tema e punësimit e trajtuar nga gratë në emisione

Sa i përketë diskutimit për punësimin, në këto emisione me gratë është diskutuar vetëm në 58 raste, përkundër 143 rasteve që nuk është diskutuar fare për çështjen e temave që ndërlidhen me punësimet.




Tabela 10 Tema e papunësisë e trajtuar nga gratë në emisione

Ndërkaq, sa i përket temave për papunësinë që janë në shumicën e rasteve edhe si pika kryesore e diskutimeve në fushatat elektorale, kjo temë nga ana e grave është diskutuar fare pak, apo në shumicën e emisioneve nuk është prekur fare kjo temë për diskutim. Kjo temë është diskutuar vetëm në 6 raste nga ana e grave që kanë qenë të ftuara në emisione, pëkundër 190 rasteve kur kjo temë nuk është diskutuar fare me gratë e ftuara në emisione.




Tabela 11 Tema e drejtësisë e trajtuar nga gratë në emisione

Edhe sa i përket një teme të rëndësishme në shoqëri, siç është fusha e drejtësisë, në emisionet në të cilat kanë qenë prezentë gratë kjo temë me të ftuarat është diskutuar vetëm në 17 raste, përkundër

179 rasteve kur kjo temë nuk diskutuar fare me panelistet apo përfaqësueset femra të ftuara në emisione.




Tabela 12 Tema e korrupsionit e trajtuar nga gratë në emisione

Edhe temat që ndërlidhen me korrupsionin janë shumë pak të diskutuara me gratë, pavarësisht që këto tema janë diskutime të përditshme në shoqëri. Sipas monitorimit në disa emisione kjo temë është trajtuar edhe me kandidatet gra, ndërsa në disa të tjera kjo temë nuk është diskutuar fare. Megjithatë në raport më numrin e përgjithshëm të të ftuareve kjo temë është diskutuar pak, ku nga 206 raste, kjo temë me gratë është diskutuar vetëm në 24 raste.




Tabela 13 Tema e mbështetjes sociale e trajtuar nga gratë në emisione

Sa i përket diskutimit për temat sociale, me gratë është diskutuar më tepër kjo temë në më shumë se gjysmën e emisioneve. Megjithatë, edhe kjo temë është diskutuar në rreth 38 raste kur të ftuara kanë qenë gratë në emisione. Në emisionin “Zgjedhjet lokale 2021”, në RTK1, kjo temë është diskutuar me të gjitha të ftuarat, kundrejt emisionit “Context”, në të cilin kjo temë nuk është diskutuar në asnjë rast.




Tabela 14 Tema e bujqësisë e trajtuar nga gratë në emisione

Edhe sa i përket temave që ndërlidhën me bujqësinë, diskutimi me gratë ka qenë i ndryshëm nëpër emisione. Por, në mesin e emisioneve ka pas edhe raste kur në asnjërin prej tyre nuk është diskutuar kjo temë. Nga numri total i pjesëmarrjes në 205 raste, vetëm në 31 raste është diskutuar kjo temë.




Tabela 15 Tema e kulturës e trajtuar nga gratë në emisione

Njëra nga temat që është diskutuar më tepër nga ana e grave në emisione është ajo e kulturës. Kjo temë është diskutuar pothuajse në të gjitha emisionet, ndërsa numri total i rasteve që është diskutuar kjo temë është 69, kundrejt 134 rasteve që as kultura nuk ka qenë pikë e diskutimit.

Ndërsa, edhe temat që ndërlidhen me sportin kanë qenë nën mesatare të diskutimit me gratë e ftuara në emisione. Në shumicën e emisioneve është trajtuar diskutimi për sportin, ku mund të cekën disa raste kur me të gjitha të ftuarat është diskutuar kjo temë siç janë emisioni “Context”, “Zgjedhjet lokale 2021”, “Zgjedhjet në kohë” dhe “Zgjedhjet komunale 2021”. Ndërkaq, në emisionin ku ka pas më së shumti të ftuara gra është diskutuar më pak kjo temë, ku nga 134 raste kur të pranueshme kanë qenë gratë vetëm është diskutuar vetëm në 25 raste.




Tabela 16 Tema e sportit e trajtuar nga gratë në emisione

Për dallim nga temat e trajtuara më lartë, kanë dominuar diskutimet me të ftuara gratë në fushën e të drejtave të grave. Nga 207 raste të përgjithshme të diskutimit në 107 është diskutuar me përfaqësueset politike gra, për temën e të drejtave të grave, ndërkaq në 96 raste ku ishin të ftuara gratë nuk është diskutuar për këtë temë.




Tabela 17 Të drejtat e grave të trajtuara nga gratë në emision

Gjithashtu, diskutimi më i theksuar me gratë pjesëmarrëse në emisionet elektorale ka qenë edhe tema arsimit, ku sikurse në fushën e të drejtave të grave edhe në arsim dominojnë diskutimet me gratë në emisionet elektorale. Nga 209 raste të diskutimit në emisione të ndryshme në 127 prej tyre gratë janë përfshirë përmes temave të ngritura në diskutim për arsimin. Në 82 raste nuk është diskutuar për arsimin kur prezente kanë qenë gratë në emision.




Tabela 18 Tema e arsimit e trajtuar nga gratë në emisione

Përfundimet

- Përfaqësimi i gruas në emisionet elektorale në televizionet e monitoruar ka qenë i vogël
- Pjesëmarrja e numrit të grave në emisionet elektorale në televizione ka qenë simbolik;
- Numri i grave të përfaqësuara nga subjektet politike ka qenë i vogël, në raport me burrat e ftuar;
- Në shumicën e rasteve kur gratë kanë qenë të ftuara në emisione e kanë pas kohën e kufizuar vetëm deri në 5 minuta;
- Në shumicën e rasteve grave të ftuara në emision iu është ndërprerë fjala, në shumë emisione deri në gjashtë herë;
- Në shumicën e rasteve në emisione temat si të shëndetësisë, drejtësisë, korrupsionit, punësimit etj, nuk kanë qenë temat kryesore që janë trajtuar nga gratë;
- Vetëm në temat për të drejtat e grave dhe për arsimin kanë dominuar me gratë të ftuara në emisione.